**VENDIM**
**Nr. 11, datë 2.3.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Bashkim Dedja | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | Anëtar i " " |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar i " " |
| Petrit Plloçi | Anëtar i " " |
| Vitore Tusha | Anëtare e " " |
| Admir Thanza | Anëtar i " " |
| Altina Xhoxhaj | Anëtare e " " |
| Sokol Berberi | Anëtar i " " |

me sekretare Enina Mullaj, në datën 20.10.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 35/11 akti, që i përket:

KËRKUES: Ndok Gjini

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra e Përmbarimit Lezhë; Bardhok Jaku, Taze Jaku

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Shfuqizimi i vendimit nr. 102, datë 18.3.2011 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberin dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi është pronar i një trualli prej 1350 $m^2$, të ndodhur në fshatin Tresh Lezhë, për të cilin zotëron certifikatën e pronësisë me nr. 5139, datë 29.5.2006. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, pas padisë së paraqitur nga kërkuesi me objekt "Kthim sendi", ka vendosur, me vendimin nr. 484, datë 20.9.2007, detyrimin e të padituve të lirojnë dhe të dorëzojnë sipërfaqen e tokës prej 300 $m^2$, pronar i së cilës është kërkuesi.

2. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 174, datë 2.4.2008. Në datën 21.5.2008, me vendimin nr. 122, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për zbatimin e vendimit civil të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007.

3. Zyra e Përmbarimit Lezhë, në datën 5.6.2009, ka shkuar në vend dhe ka kryer veprimet përmbarimore përkatëse. Sipas procesverbalit të përpiluar për kryerjen e veprimeve përmbarimore, Zyra e Përmbarimit Lezhë ka nxjerrë vendimin nr. 196/ç prot., datë 8.6.2009, për pushimin e urdhrit të ekzekutimit, duke e konsideruar vendimin gjyqësor të ekzekutuar plotësisht.

4. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me veprimet e përmbaruesit gjyqësor, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me padi me objekt "Kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 843, datë 29.7.2009, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të ekzekutimit nr. 196/ç prot. datë 8.6.2009 dhe urdhërimin e Zyrës së Përmbarimit Lezhë për vazhdimin e procedurave të ekzekutimit.

5. Mbi ankimin e palëve, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 609, datë 13.12.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil nr. 843, datë 29.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

6. Kundër këtij vendimi të Gjykatës së Apelit Shkodër ka paraqitur rekurs pala e paditur dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 102, datë 13.03.2011 ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 609, datë 13.12.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

7. *Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim "Gjykata"), duke pretenduar se:

7.1 i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për arsye të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;

7.2 vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

8. *Subjekti i interesuar*, Zyra e Përmbarimit Lezhë, për të kundërshtuar pretendimet e kërkuesit në lidhje me afatin e arsyeshëm, ka paraqitur me shkrim parashtrimet mbi veprimet përmbarimore të kryera për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 484, datë 20.9.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Sipas kësaj zyre, veprimet përmbarimore janë kryer në përputhje me legjislacionin përmbarimor në fuqi dhe nuk janë bërë shkak për cenimin e afatit të arsyeshëm, për sa i përket ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

9. *Subjektet e interesuara*, Bardhok Jaku dhe Taze Jaku kanë paraqitur me shkrim parashtrimet e tyre dhe kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës duke pretenduar se: a) kërkesa nuk përmban asnjë element që do të përbënte shkelje kushtetuese; b) pretendimet e kërkuesit janë të pambështetura; c) vendimi i Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit është i drejtë.

II

*A. Për pretendimin e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës*

10. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për arsye të mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Sipas kërkuesit, që prej marrjes formë të prerë të këtij vendimi dhe lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nr. 122, datë 13.5.2008, ka kaluar një kohë e gjatë, e cila është e pajustifikuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

11. Gjykata është shprehur edhe më parë se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) (*shih vendimin nr. 6, datë 7.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë (*shih vendimet nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura Gjykata konstaton se kërkuesi është pronar i sipërfaqes së tokës prej 1350 $m^2$, të ndodhur në fshatin Tresh Lezhë, sipas certifikatës së pronësisë me nr. 5139, datë 29.5.2006 të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRRPP), Lezhë. Vendimi nr. 484, datë 20.9.2007 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, objekt i këtij shqyrtimi, ka detyruar të paditurit të lirojnë dhe të dorëzojnë sipërfaqen e tokës prej 300 $m^2$, pronar i së cilës është kërkuesi. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 174, datë 2.4.2008 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, pasi ka konstatuar se vendimi nr. 484, datë 20.09.2007, ka marrë formë të prerë në bazë të dispozitave procedurale civile përkatëse, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për zbatimin e tij.

13. Zyra e Përmbarimit Lezhë ka filluar procedurat përmbarimore për zbatimin e vendimit gjyqësor nr. 484, datë 20.9.2007. Sipas parashtrimeve të paraqitura, fillimisht kjo zyrë i ka dërguar palës debitore, në datën 31.3.2009, lajmërim për ekzekutim vullnetar dhe më pas në datën 23.4.2009 ka nxjerrë vendim për kalim në ekzekutim të detyrueshëm. Në datën 5.6.2009 zyra e përmbarimit, Lezhë ka kryer në vend identifikimin dhe përcaktimin e sipërfaqes 300 $m^2$, objekt ekzekutimi, dhe ka liruar në favor të

kreditorit një pjesë të kësaj sipërfaqeje, duke mos ekzekutuar vendimin gjyqësor për pjesën tjetër të sipërfaqes. Sipas procesverbalit të mbajtur mbi këto veprime përmbarimore, Zyra e Përmbarimit Lezhë, ka nxjerrë vendimin nr. 196/ç prot., datë 8.6.2009, për pushimin e urdhrit të ekzekutimit, duke e konsideruar vendimin gjyqësor, objekt shqyrtimi, të ekzekutuar plotësisht.

14. Kërkuesi, ka kundërshtuar veprimet e përmbaruesit gjyqësor, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila pasi ka vlerësuar se veprimet përmbarimore nuk janë kryer në përputhje me pjesën urdhëruese të vendimit të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të ekzekutimit nr. 196/ç prot. datë 8.6.2009 dhe urdhërimin e zyrës së përmbarimit Lezhë për vazhdimin e procedurave të ekzekutimit deri në ekzekutimin e plotë të vendimit.

15. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 609, datë 13.12.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil nr. 843, datë 29.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Pas ushtrimit të rekursit ndaj këtij vendimi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 102, datë 13.3.2011 ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 609, datë 13.12.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

16. Mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Kancelaria e Gjykatës së Lartë (shkresa nr. 229 prot. datë 27.9.2011) rezulton se në datën 19.05.2011 është regjistruar në Gjykatën e Lartë çështja civile me objekt "kundërshtim i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor" ku palë ndërgjyqëse janë kërkuesi dhe subjektet e interesuara në çështjen objekt i këtij shqyrtimi kushtetues. Kancelaria e Gjykatës së Lartë bën me dije Gjykatën se kjo çështje ndodhet në fazë studimi dhe në pritje për të kaluar për shqyrtim në Dhomë Këshillimi.

17. Nisur nga fakti i mësipërm, Gjykata konstaton se çështja konkrete është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe për pasojë vlerëson se nuk jemi në kushtet e cenimit të standardit të afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Në lidhje me veprimet e zyrës së përmbarimit Lezhë, si organ shtetëror i ngarkuar me përgjegjësinë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, Gjykata çmon se kjo zyrë ka kryer të gjitha veprimet që i lejon ligji, për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë të gjykatës, në përputhje me dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

18. Si përfundim, duke pasur parasysh faktin se palët janë ende në proces dhe veprimet konkrete të institucioneve shtetërore kanë qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, Gjykata konkludon se nuk është cenuar parimi kushtetues i afatit të arsyeshëm, në lidhje me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

*B. Për pretendimin e mosarsyetimit të vendimit gjyqësor*

19. Kërkuesi pretendon, gjithashtu, se vendimi nr. 102, datë 13.03.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, pasi dispozitivi i vendimit nuk përputhet me arsyetimin e tij.

20. Gjykata, në jurisprudencën e saj ka rikonfirmuar qëndrimin se arsyetimi i vendimeve gjyqësore është një element i së drejtës për një proces të rregull ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.

21. Megjithatë, duke pasur parasysh se çështja është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, Gjykata konstaton se, vendimi i Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, objekt shqyrtimi, është një vendim i ndërmjetëm, jopërfundimtar. Kërkuesit do t'i jepet një zgjidhje përfundimtare vetëm pasi çështja të shqyrtohet nga Gjykata e Lartë dhe kjo e fundit të shprehet me një vendim përfundimtar.

22. Në këto rrethana, duke qenë se procesi është ende i papërfunduar, Gjykata çmon se edhe ky pretendim i kërkuesit është i pambështetur.

23. Përfundimisht, për sa më sipër, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata nuk gjen elemente të një procesi të parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar) Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

Anëtarë kundër: Petrit Plloçi, Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, për sa i takon rrëzimit të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice. Shumica në këtë çështje, pretendimin e kërkuesit për mosekzekutim të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, e ka çmuar të pabazuar, me argumentin se çështja është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe për pasojë nuk është cenuar parimi kushtetues i afatit të arsyeshëm, në lidhje me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Në rastin konkret, pakica e konsideron të rëndësishme të ritheksojë parimet kushtetuese që rregullojnë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës prerë brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) është shprehur se nenet 42, 142/3 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 6, datë 7.3.2011; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 27, datë 20.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Siç është pohuar dhe nga shumica, ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr. 6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të prekë thelbin e së drejtës (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 12.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 6, datë 4.3.2010; nr. 43, datë 19.12.2007*).

Duke iu referuar standardeve të mësipërme, pakica, në ndryshim nga shumica, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me cenim të afatit të arsyeshëm në lidhje me ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, mbi bazën e arsyetimit që shtjellohet në vijim. Pakica rikonfirmon qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 14, datë*

*15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009*).

Nga rrethanat e çështjes konkrete rezulton se procedura gjyqësore ka filluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila me vendimin nr. 484, datë 20.9.2007, ka vendosur detyrimin e subjekteve të interesuara, Bardhok e Taze Jaku, të lirojnë dhe të dorëzojnë sipërfaqen e tokës prej 300 $m^2$, pronar i së cilës është kërkuesi. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe, në përputhje me dispozitat procedurale civile, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për zbatimin e vendimit civil të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007. Zyra e përmbarimit Lezhë në datën 5.6.2009 ka kryer veprimet përmbarimore përkatëse dhe pasi ka shkuar në vend, mbi bazën e procesverbalit të mbajtur, ka nxjerrë vendimin nr. 196/ç prot. datë 8.6.2009 për pushimin e ekzekutimit, pasi sipas saj, vendimi ishte ekzekutuar plotësisht dhe debitori kishte plotësuar detyrimin ndaj kreditorit. Kërkuesi ka kundërshtuar veprimet e përmbaruesit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë e cila, me vendimin nr. 843, datë 29.7.2009 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të ekzekutimit nr. 196/ç prot., datë 8.6.2009, dhe urdhërimin e Zyrës së Përmbarimit Lezhë për vazhdimin e procedurave të ekzekutimit. Më tej, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 609, datë 13.12.2010, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Nisur nga faktet më sipër, pakica vëren se, që nga nxjerrja e urdhrit të ekzekutimit e deri në momentin e bërjes së kërkesës përpara kësaj gjykate, kanë kaluar rreth 3 (tre) vjet dhe ky urdhër ende nuk është zbatuar plotësisht. Mbi bazën e certifikatës së pronësisë nr. 5141, datë 29.5.2006, kërkuesi është pronar i truallit mbi të cilin disponon vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007. Si pronar i ligjshëm ai ende nuk e ka rivendosur në vend të drejtën e pronës, që është cenuar si pasojë e mosekzekutimit tërësor të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Lidhur me kompleksitetin e çështjes, Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, vëllimin e provave shkresore (shih vendimin nr. 21, datë 3.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese). Çështja objekt gjykimi, në vlerësimin e pakicës, nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara nga ligji për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Nga certifikata e pronësisë dhe vendimet gjyqësore, është e qartë se sipërfaqja e tokës, të cilën subjektet e interesuara e përdorin në mënyrë të jashtëligjshme, është në pronësi të kërkuesit.

Për sa i përket sjelljes (veprimeve) të kërkuesit, rezulton se ai ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Pakica çmon se sjellja e kërkuesit nuk është bërë shkak për tejkalimin e afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Kërkuesi i ka ushtruar të gjitha mjetet ankimore të njohura nga ligji, në përputhje me afatet e përcaktuara nga dispozitat procedurale civile. Për më tepër, nga dokumentet e shqyrtuara, vërehet se sjellja e kërkuesit ka qenë aktive, duke iu drejtuar institucioneve përkatëse shtetërore për rivendosjen e së drejtës së tij të fituar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë.

Në vijim, pakica vlerëson nëse autoritetet shtetërore përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, në rastin konkret, përmbaruesi gjyqësor ka marrë ose jo masat e nevojshme për zbatimin e urdhrit të ekzekutimit, në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë. Zyra e Përmbarimit Lezhë, në datën 31.3.2009 ka dërguar fillimisht njoftim për ekzekutim vullnetar dhe në datën 23.4.2009 ka marrë vendim për ekzekutim të detyrueshëm. Në datën 5.6.2009, Zyra e Përmbarimit ka kryer veprimet përmbarimore përkatëse për zbatimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Mbi bazën e procesverbalit të mbajtur në vend, kjo zyrë ka nxjerrë vendimin nr. 196/ç prot. datë 8.6.2009, për pushimin e urdhrit të ekzekutimit, pasi e ka konsideruar vendimin gjyqësor të ekzekutuar plotësisht. Megjithatë, duke iu referuar vendimeve gjyqësore të bashkëlidhura në dosje, rezulton se urdhri i ekzekutimit është zbatuar pjesërisht dhe jo plotësisht; subjektet e interesuara nuk e kanë liruar banesën e ndërtuar në mënyrë të paligjshme në pronën e kërkuesit. Zyra e Përmbarimit, edhe pse me vendimin nr. 843, datë 29.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është urdhëruar të vazhdojë procedurën e ekzekutimit, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim përmbarimor deri në nxjerrjen e vendimit nr. 102, datë 18.3.2011 të Gjykatës së Lartë për

pezullimin e ekzekutimit. Vetëm pas këtij vendimi, Zyra e Përmbarimit ka nxjerrë vendimin e pezullimit nr. 593/ç, datë 31.3.2011. Pavarësisht vendimit të ndërmjetëm të Gjykatës së Lartë, sipas së cilit është pezulluar ekzekutimi, pakica vlerëson se kjo nuk përbën arsye të justifikuar për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007. Duke pasur parasysh se veprimet përmbarimore për ekzekutimin e këtij vendimi kanë filluar në datën 27.3.2009, pakica konstaton se afati i ekzekutimit është zgjatur në mënyrë të paarsyeshme nga mosveprimet e Zyrës së Përmbarimit. Këto mosveprime janë bërë shkak për mosekzekutimin tërësor të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Gjithashtu, pakica vë në dukje se, asnjë instancë gjyqësore nuk ka shfuqizuar ose ndryshuar vendimin nr. 484, datë 20.9.2007, objekt shqyrtimi. Argumenti i përdorur nga shumica se nuk jemi në kushtet e cenimit të parimit kushtetues të afatit të arsyeshëm, në lidhje me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, për arsye se palët janë ende në proces në Gjykatën e Lartë, nuk është i mbështetur. Pakica vëren se subjektet e interesuara kanë kërkuar në Gjykatën e Lartë pezullimin e vendimit nr. 609, datë 13.12.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër, supra, dhe nuk kanë kundërshtuar vendimin e formës së prerë nr. 484, datë 20.9.2007, i cili është objekt i këtij gjykimi, për sa i përket ekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm.

Nisur nga argumentet e mësipërme, pakica vlerëson se pretendimi i kërkuesit, për mosekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, është i bazuar dhe duhej të pranohej nga Gjykata.

Anëtarë: Sokol Berberi, Petrit Plloçi